



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 58/2 prot,

Datë 16.01.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*SPARKLE 32*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur – mallra, Marrëveshje Kuadër*”, me Nr. *REF-51782-12-01-2022*, me objekt “*Shpenzime për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, për Agjencinë e Shërbimit Komunal*” me fond limit 10.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 19.12.2022, Ndërmarrja Komunale Kuçovë.

Ankimues: Operatori ekonomik “*SPARKLE 32*” SHPK
*Adresa: Lagjia “Frutikulturë”, Rruga “Bulevardi Blu”,
Ndërtesë private nr. 115, Kamëz, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja Komunale Kuçovë
Adresa: Sheshi 18 Tetori, Blloku “Tafil Skëndo”, Kuçovë.

Në datën 16.01.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 58 prot, e operatorit ekonomik “*SPARKLE 32*” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur – mallra, Marrëveshje Kuadër*”, me Nr. *REF-51782-12-01-2022*, me objekt “*Shpenzime për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, për Agjencinë e Shërbimit Komunal*” me fond limit 10.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 19.12.2022, Ndërmarrja Komunale Kuçovë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*SPARKLE 32*” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon. a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi*

kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “SPARKLE 32” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 58 prot, datë 16.01.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik “Sparkle 32” nuk plotëson pikën 2.3.4 të DST për mjetin e kërkuar, pasi deklarata nuk është bërë në përputhje me formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 8. Gjithashtu dhe dokumentat e paraqitura për mjetin AB856HU i mungon leja e transportit.

Mungojnë specifikimet teknike për mostrat tel elektrik 1.5 mm², kabëll elektrik 4x6 mm², kabëll elektrik 2x1.5 mm², tel elektrik 2.5mm², driver për ndriçues rrugor, rele muzgu për ndriçim rrugor dhe drossel.

Për të gjithë ndriçuesit LED mungon specifikimi i orëve të punës. Lloji i ndriçimit për ndriçuesit LED 50Ë dhe LED 150Ë, sipas specifikime të paraqitura nga ana e OE është 4500K, ndërkohë që kërkohet 5000K, për ndriçuesin LED 100Ë sipas specifikimeve të paraqitura nga ana e OE është 4500K ndërkohë që kërkohet 6000K.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.01.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënryetar
Fiorent Zguro